

C' FARËMUND TË BËNI NË PRANI TË PARAZITËVE

TRAJTIMI

PËR SAKTËSI DUHET TË BËNI NJË KONTROLL TË RREPTË TË KOKËS DHE VETULLAVE PËR TU SIGURUAR PËR PRANINË E PARAZITËVE „NË VECANTI TEK GROPA E QAFËS, TEK TËMTHAT E KOKËS DHE PAS VESHËVE.

NË KËTË RAST DUHET TË PËRDORNI NJË PRODUKT TË CAKTUAR (I CILI MUND TË JETË SHAMPO, GEL OSE SHKUMË) DUKE NDJEKUR ILUSTRIMIN QË PËRMBAN AMBALLAZHI

DUHET TË HIQNI TË GJITHË PARAZITËT. KY VEPRIM MUND TË KRYHET ME DORË OSE ME NJË KRËHËR ME DHEMBË SHUMË TË VEGJËL .PËR TË LEHTËSUAR KËTË VEPRIM MUND TË PËRDORNI NJË PËRZJERIE ME UJË TË NXEHTË DHE UTHULL(NË PJESË TË BARABARTA).

KY VEPRIM DUHET TË PËRSËRITET PAS 7-8 DITËSH PËR TË HEQUR PARAZITËT E MBIJETUAR.

DUHET TË LANI RROBAT E BRËNDËSHME NË (60°-C) DHE TË GJITHA RROBAT QË JANË NË KONTAKT ME KOKËN (KAPELE, SHAJE, JAKAT E XHAKETAVE ,LODRA PREJ RROBE ETJ).LANI DHE DIZINFEKTONI KRËRAT DUKE I FUTUR NË UJË TË NXEHTË PËR 10 MINUTA, OSE PËRDORNI EDHE PRODUKTE TË CAKTUARA.

PASTRONI MIRË VENDIN KU RRINË FËMIJËT (DIVAN, KOLLTUK DHE TAPETE)ME FSHESË ME KORENT. NË QOFTË SE NJË NGA PJESTARËT E FAMILJES DO TË KETË PARAZITË , VEPRIMET E MËSIPËRME DUHET TË KRYHEN PËR TË GJITHË PJESËTARËT E SAJ.

NUK ËSHTË E RËNDËSISHËME DIZINFEKTIMI I AMBIENTIT, PASI PARAZITËT NUK JETOJNË SHUMË GJATË LARG LËKURËS SË KOKËS

NUK ËSHTË E RËNDËSISHËME TË PËRDORNI PRODUKTE TË CAKTUARA PËR PARANDALIMIN , AS TU PRISNI FLOKËT FËMIJËVE.

PARANDALIMI

EDUKONI FËMIJËT TË MOS NDËRROJNË KAPELE, SHAJE APO KAPSE FLOKËSH ME SHOKËT DHE SHOQET.

KONTROLLONI SHPESH HERË FËMIJËT NË KOKË.